



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 1618 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1838, datë 24.07.2017.

**SHOQËRISË “ALBAVIA SINTRAM” SH.P.K
Rr. “Sulejman Delvina”, Pallati Fati, Ap.19, Tiranë**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “ALBAVIA SINTRAM” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1838, datë 24.07.2017, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Trebinjë”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Me anë të shkresës Tuaj Nr.749, Prot, datë 12.07.2021, protokolluar në MIE, me Nr. 5597, Prot. datë 13.07.2021, subjekti “ALBAVIA&SINTRAM” sh.p.k, ka kërkuar Revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit, Nr. 1838, datë 24.07.2017, dhënë për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, në objektin “Trebinjë”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, për arsye të përfundimit të punimeve të Lotit 1, të segmentit rrugor Qukës-Qafë Plloçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2698/3, datë 07.12.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.5597/2, Prot, datë 09.12.2021, është shprehur dakord për revokimin e Lejes së Shfrytëzimit Nr.1838, datë 24.07.2017, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Trebinjë”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014, datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit** e Lejes së Shfrytëzimit Nr.1838, datë 24.07.2017, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Trebinjë”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes së Shfrytëzimit Nr.1838, datë 24.07.2017, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Trebinjë”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

